



Në bazë të nenit 5, paragrafi 2 të Rregullores nr. 05/2025 për angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve (OSH) në procesin e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH), Autoriteti i Likuidimit shpallë këtë:

Konkurs per Ofrues të Shërbimeve në procesin e likuidimit

Titulli i pozitës së punës	Ofrues i Shërbimeve – Zyrtar Ligjor
Kohëzgjatja e emërimit	1 vjet (me mundësi vazhdimi)
Paga :	Pagesa për Ofruesit e Shërbimeve është 650 €. Në këtë shumë përfshihen edhe pagesa për kontributet pensionale (5%) nga punëdhënësi dhe (5%) nga punëmarrësi dhe tatimit në burim sipas legjislacionit në fuqi. Pagesa bëhet përmes paraqitjes së raportit të mbikqyrësit tek Autoriteti i Likuidimit
Nr. i kërkuar	30
Data e njoftimit	08.12.2025
Afati për aplikim	15.12.2025
Institucioni	Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Departamenti	Departamenti i Koordinimit Rajonal
Divizioni	Zyra Rajonale Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit i PRN115 NSH Ratar
Vendi i punës	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme
Nr. i Referencës	08.12.2025 – OSH Zyrtar Ligjor

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Qëllimi i pozitës është ofrimi i mbështetjes profesionale ligjore në menaxhimin, regjistrimin dhe administrimin e lëndëve në procesin e likuidimit të NSH-ve që trajtohen në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të KGJK-së dhe AKP-së.

2. Detyrat Kryesore:

- Organizon dhe mirëmban shkresat e dosjeve të lëndëve në gjykatë si dhe kujdesët për të ofruar punë cilësore;
- Pranon dhe regjistron lëndët sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli;
- Përgatit të gjitha lëndët të cilat i kanë plotësuar kushtet ligjore për regjistrim dhe i raporton te mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë;
- Sipas kërkesës ndihmon shtypjen e vendimeve dhe shkresat tjera të gjykatës, përfshirë përgatitjen e dosjeve të lëndëve gjyqësore;
- Kryen edhe detyra tjetër sipas kërkesës së mbikëqyrësit dhe përgatitë raportet javore të punës;
- Me udhëzim të mbikëqyrësit paraqet raporte dhe informata tjera të kërkuara për mbarëvajtjen e procesit të Likuidimit për Autoritetin e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim;



3. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse në pikëpamje shëndetësore (kërkohet vetëm për kandidatët që shpallen fitues);
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; (kërkohet vetëm për kandidatët që shpallen fitues);
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Përparësi kanë kandidatët që kanë punuar në punë të ngjashme ose kanë qenë më parë të angazhuar si Ofrues Shërbimesh për detyra të ngjashme; dhe
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë rregullore.

4. Kërkesat e përgjithshme formale

- Diplomë Universitare: Jurist i diplomuar
- Së paku 1 (një) vit përvojë pune

5. Kërkesa specifike

- Shkathtësi të shkëlqyera gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim.
- Njohja e punës me kompjuter (Word dhe Excel).

6. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

1. Aplikacioni i punësimit përmban të dhënat si më poshtë:
 - 1.1. referencën e shpalljes së procedurës së rekrutimit;
 - 1.2. titullin e vendit të punës dhe institucionin;
 - 1.3. të dhënat personale të kandidatit
 - 1.4. nivelin e arsimit, si dhe diplomat e fituara, institucionet arsimore, datat e diplomimit;
 - 1.5. një përshkrim të hollësishëm të përvojës së punës, duke përfshirë të dhëna si:
 - 1.5.1. emrin e punëdhënësit;
 - 1.5.2. titullin, gradën dhe/apo të ngjashme;
 - 1.5.3. kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës;
 - 1.5.4. përshkrimin e detyrave kryesore të punës;
 - 1.5.5. numrin dhe llojin e personelit nën mbikëqyrje, nëse ka;
 - 1.5.6. adresën dhe kontaktin e punëdhënësit paraprak;
 - 1.5.7. arsyet për përfundimin e marrëdhënies/eve paraprake të punës.
 - 1.6. njohuritë gjuhësore;
 - 1.7. informata mbi trajnimet e veçanta të kryera apo të ofruara, kualifikimet profesionale dhe specializimet, aftësitë e veçanta dhe publikimet nëse kërkohen në konkurs;
 - 1.8. njohuritë kompjuterike.
2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim:
 - 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë



- 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit;
- 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion;
- 2.4. kopjen e dëshmisë së vlerësimit të performancës së punës në tre vitet e fundit, nëse ka.
- 2.5. kopja e letërnjoftimit apo dokument identifikimi

3. Kandidatët e plotësojnë aplikacionin në pajtim me Ligjin përkatës për Përdorimin e Gjuhëve.

7. Mënyra e Aplikimit

- Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara, siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit;
- FORMULARI I APLIKIMIT - formularin mund ta shkarkojnë në Ueb Faqen e AKP-së. (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>), [DAADE23B-4E75-4DF9-8043-E7F5FE5B5CB0.doc](#) Shkarko Aplikacionin
- Deklarimi i rrejshëm sipas këtij neni paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit;
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë përfshirë edhe ato të dorëzuara me postë nuk pranohen, dhe aplikacionet e pa kompletuara refuzohen.
- Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe i lexueshëm;
- Pranimi i aplikacioneve nga kandidatët për pranim bëhet brenda SHTATË (7) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit
- Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kompletuar më së largu me datë 15.12.2024 në ora 16:00 në emalin punesimi@pak-ks.org apo në Agjencinë Kosovare të Privatizimit - Zyra Rajonale të Prishtinës me adresë në Rr. "Dritan Hoxha", 55, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

7. Data e shpalljes së rezultateve të vlerësimit përfundimtar

- Lista e kandidateve sipas vlerësimit përfundimtar, do të shpallet më së largu deri më datën 30.12.2025, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>).

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes kontakt telefonit, SMS dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>)
-